REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA KLOKOT / KOMUNA E KLLOKOTIT
Nr. 1015/2 Dt. 28.05 2011
KLOKOT / KLLOKOT

# Opština Klokot-Vrbovac

**Komuna e Kllokot-Vrbovcë Municipality of Klokot- Vrbovac**

Në bazë të udhëzimit neni 12 dhe 17 Ligjit mbi Vetqeverisjne Lokale Nr. 03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë 04.06.2010.dhe neni 8.pika(n) Statutit të Komunës Kllokot-Vërbovc Kuvendi Komunal Kllokot-Vërbovc,merr:

## RREGULLORE NR:04/2011
## PËR LEJIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISE SË AFARIZMIT
## I.RREGULLAT E PËRGJITHSME

Neni 1.Rregullat dhe Objektivat

Rregullorja për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së afarizmit është përcaktuar:

- Detyrimet e subjektit të biznesit duhet të posedojë licencë për ushtrimin e afarizmit
- Kushtet dhe procedurat e dhënjes së lejës për ushtrimin e afarizmit
- Detyrimet për të zbatuar rregulloren
- Organin mbikqyrës dhe rregullat penale
- Proceduart për paraqitjen e ankesave.

## II.DETYRIMET E SUBJEKTIT TË BIZNESIT DUHET TË POSEDOJNË LICENCË PËR USHTRIMIN E AFARIZMIT

Neni 2.Tatimpaguesit

Bizneset e regjistruara në Ministrinë për Tregti dhe Industri për shpalljen e caktuar,të ushtrimit të afarizmit,para fillimit të punës në teritorin e Komunës Kllokot-Vërbovc,duhet të jenë të pajisur me lejen për shpalljen e aktivitetit të biznesit me kushtet dhe proceduart të cilat janë përcaktuar me këtë Rregullore.

## III.KUSHTET DHE PROCDURAT E DHËNJES SË LEJES

**Neni 3.Kushtet për dhënjen e lejës për ushtrimin e aktivitettit të biznesit**

1.Certifikatën e regjistrimit të biznesit,e cila është në shqyrtim dhe një kopje.

2.Dokumentat-të dhenat dhe informtata e regjistrimit të biznesit i cili është në shqyrtim dhe një kopje.

3.Vërtetimi i pronës ose vërtëtimi mbi posedimin e strukturës së objektit për ushtrimin e aktivitetit të biznesit.

4.Vërtetimin mbi certifikatën e objektit për plotësimin e kushteve tekniko-higjieno-sanitare dhe kushtet tjera të parapara për aktivitetin e biznesit.

5.Vërtetimin për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë,përfshirë edhe për objektin për të cilin kërkohet leja e punës.

6.Vërtetimi për pagesën e obligimeve tjera të parapara në këtë Rregullore për normal e komunës,shpenzimet dhe dënimet për periudhën e e dhenjës së lejes së punës,lejen e saktë për aktivitetin e biznesit.

7.Të dhënat të cilat janë paraparë sipas udhëzimeve logjore dhe rregullores së komunës për lejimin e ushtrimit të aktivitetit të biznesit.

**Neni 4.Parashtrimi i kërkesës**

Kërkesat dhe vërtetimet e duhura të caktuara për dhënjen e lejes për ushtrimin e aktivitetit të biznesit për objekitn në të cilin do të ushtrohet biznesi,dorëzohen tek Drejtoria për Buxhet,Financa dhe Zhvillim Ekonomik.

Neni 5.Dhënja e lejes së ushtrimit të aktivitetit të biznesit afati dhe vazhdimi i lejes

5.1.Drejtoria për Buxhet,Financa dhe Zhvillim Ekonomik ,përmes kërkesës së njësive të biznesit të cilët i plotësojnë kushtet e parapara më ligj dhe rreullores së komunës për ushrimin e aktivitetit të biznesit në objektin e caktuar,merr Vendimin për dhënjen e lejes për ushtrimin e aktivitetit të biznesit.
5.2.Leja do të ipet në periudhën kohore,sikurse është cekur mëë poshtë:
a) Subjektet afariste të cilat mirren me veprimtari komerciale,të cilat janë në harmoni me dispozitat e ligjit për tregëti të mbrendshme dhe posedojnë vërtetimin e pronës për objektin e caktuar,leja do të ipet në periudhën e vazhdimit të përhershëm ,ndërsa shfrytëzimi i objektit të biznesit në bazë të nënshkrimit të Kontratës mbi qiranë,leja do të jipet gjatë periudhës së Kontratës së qerasë.
b) Për subjeketet afariste të cilat merren me tjera biznese,leja për ushtrimin e aktivitetit të biznesit do të lëshohet në mënyrë tjetër:për subjektet afariste të cilat janë në pronësi,leja ipet në afatin e vazhdueshëm e paraparë sipas udhëzimeve ligjore për kryerjen e veprimtarive të caktruara ndërkaq për leje të cilat shfrytëzohen sipas kontratës së nënshkruar për qeranë lejet do të jepen në periudhën kohore sa zgjat edhe kontrata mbi qeranë e jo më gjatë nga periudha e përcaktuar me dispozita ligjore.
c) Për objektet afariste të cilat sipas dispozitave ligjore disponojnë licencën e punës leja do të jipet në kohëzgjatje saë edhe licenca.

5.3.Lejet e dhëna në bazë të paragrafit nga neni paraprak do të ndërpriten së vazhduari në rastet kur subjektet afariste kryejnë shlyrjen e punëve dhe veprimtarive për të cilat ka marrë leje nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

5.4. Drejtoria përt Buyxhet,Financa ,Ekonomi dhe Zhvillim do të merr vendim për ndësrprejen e lejes duke u bazuar në vërtetimin për shlyrjen e veprimtarisë afariste pranë Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë për atë objket për të cilin është dhënë leja si dhe në kryerjen e obligimeve të përcaktuara me rregullore për taksat komunale tarifat dhe gjobat.

**Neni 6.Marrja e lejeve**

Lejet do të merren nga ana e Drejtorisë për Buxhet,Financa Ekonomi dhe Zhvillim në rastet kur subjekti afarist:

1. Në bazë të konstatimit të drejtorisë për inspektim të tregut subjekti afarist kryen veprimtari për të cilat nuk ka marrë leje.

2. 2.Kur subjekti afarist nuk kryen oblogimet në dy kiste të përcaktuara në nivelin vjetor për mbajtjen e lejes për kryerjen e punëve përkatësisht veprimtarive afariste ,të përcaktuara me rregulloren komunale për taksa,tarifa dhe gjoba.

## OBLIGIMET PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORËS.

## Neni 7 Obligimet e subjekteve afariste

**7.1.** Subjektet afariste janë të obliguara që gjatë kryerjes së veprimtarisë të respektojnë dispozitat e përcaktuara me këtë rregullore.
**7.2.** Subjektet afariste janë të obliguara që vendimin për leje për kryerjen e veprimtarive afariste ta vendosin në vend ku shihet në objektin afarist.

## Neni 8-Obligimet e Drejtorsë për Buxhet,Financa Ekonomi dhe Zhvillim

8.1. Drejtoria për Buxhet,Financa ,Ekonomi dhe Zhvillim,në zbatimin e kësaj Rregullore do të sigurojë sinë vijim:

a) ofrimin e ndihmës ligjore subjektit afarist për zbatimin udhëzimeve të kësaj rregulloreje.
b) të shqyrtoj kërkesat e subjekteve afariste për dhënjen e lejeve dhe veprimin për përcaktimin e afatit prej 30 ditësh,nga dita e dorëzimit të kërkesës për marrjen e një vendimi të caktuar.
c) në pajtueshmëri me udhëzimet e nenit 5 dhe 6 të kësaj Rregullore,merr vendimin mbi ndërprerjen e validitetit dhe ndërprerjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
d) të udhëheqë evidencë të posacshme të subjektit afarist cili posedon leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

## Mbikqyrja inspektuese dhe rregulloret e denimeve

## Neni 9.Kontrolla e inspeksionit

9.1. Kontrolla e inspoeksionit për zbatimin e kësaj rregullore do të merret Drejtoria e Inspeksionit për Trgëti.

9.2. Inspektori i tregut ,gjatë inspektimit të objektit afarist që ushtron veprimtarinë në teritorin e komunës pa leje me vendim do të ti tërhiqet vërejtja me shkrim personit që në afat prej 30 ditësh të paiset me leje pune.

9.3. Inspektori i tregut,i objektit afarist i cili ëështë i regjistruar në bazë të rregullave ligjore përkohësisht i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë deri sa subjekti të paiset meleje pune. Ku edhe pas vërejtjeve personi vazhdon ta ushtroj veprimtarinë ndaj tijë do të mirren edhe masa tjera të cilat janë në harmoni me ligjet ,ose objektit afarist do ti shkruhet fletparaqitje për kundërvajtje,e cila është në përputhshmëri me dispozitat e nenit 10 të kësaj Rregullore.

## Neni 10.Dispozitat ndëshkimore

Në bazë të fletparaqitjes për kundërvajtje Inspektorit të Tregut ,subjetit afarist do të ndëshkohet për kundërvajtje.

A. Në vlerë prej 200€ ndëshkohet pronari i subjektit të biznesit i regjistruar në cilësinë e personit fizik,i cili edhe përkundër vërejtjeve,gjegjësisht të masave të imponuara të cilat janë në përputhje me nenin 9.paragrafi 9.2 dhe 9.3 të kësaj Rregullore,ngase nuk është paisur me lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
B. Në vlerë prej 500 € ndëshkohet pronari i subjektit afarist,i regjistruar në cilësinë e personit juridik dhe në vlerë prej 200€ ndëshkohet personi përgjegjës dhe juridik,i cili edhe për kundër vërejtjeve gjegjësisht të masave të imponuara të cilat janë në përputhje me nenin 9. paragrafi 9.2 dhe 9.3 të kësaj rregullore,nuk është paisur me lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

## PROCEDURAT E PARASHTRIMIT TË ANKESAVE

### Neni 11. Parashtrimi i ankesës

11.1. Të gjitha subjektet afariste,në përputhje me dispozitat Ligjore mbi proceduart administrative,mund të paraqesin ankesë,nëse është i pakënaqur me vendimin e marrë në bazë të dispozitave të kësaj Regullore.

## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 12. . Hyrja në fuqi

12.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e aprovimit të tij në Kuvendin Komunal të Kllokot-Vërbovcit dhe 8 ditë nga vendosja në tabelën e shpalljeve të Komunës.

**Arsyetim:**

Aprovimi i kësaj Rregullore,është bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat ,që zbatohen nga komuna,e cila është në përputhje me dispozitat e nenit 12 dhe 17 Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale br.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 04.06.2008,si dhe dispozita e ninit 8. pika (n) Statutit të Komunës Kllokot-Vërbovcnga dita

Gjithashtu ,aprovimi i kësaj Rregullore është bazuar në dispozitat ligjore,të cilat rregullojnë funksionimin e veprimtarisë së caktuar me të cilën janë përcaktuar obligimet e subjekteve afariste që para fillimit të punës në objekt,i ploteësojnë kriteret tekniko-higjieno –sanitare dhe të tjera,si dhe pajisjen me lejen e punës nga ana e organeve administrative komunale.

Në lidhje me këto dispozita sipas nenit 38.paragrafi 8.1 dhe 38.3 Ligjit mbi Tregëtinë e Mbrendshme Nr.2004/18 ku ndërprehet procedura ku duhet të bëhet rregullimi i kushteve minimale për punë parashihen obligimmet përgjegjëse të organeve administrative komunale për dhënjen e lejës për punë. Me dispozitat e nenit 72 të Ligjit mbi veprimtasrinë Turistike dhe Hoteliere nr 2004/16 ,parashihen obligimet e punës lejen përt objektin – hotel,e cila lëshohet nga personi i autorizuar komunal.

Bazuar në dispozitat e rregullorës në nenit 1 propozuar pyetja e cila do të jetë lënda e rregullimit sipas rregullores.

Duke marrur parasysh që është e paraparë që leja e punës ipet në kohëzgjatje për nji vit kalendarik,është në kundërshtim me nenin 38 paragrafi 38.4.Ligjit mbi Tregëtinë e Mbrendshme Nr.2004/18 ku është e paraparë që leja e punës për subjektin e cila ushtron veprimtarinë në lëminë e tregëtisës i ipet leja e përhershme,dhe simbas ligjeve tjera dhe dispozitave të rregulluara me afatin e lejeve të punës janë të përcaktuar edhe aktivitetet afariste.Në nenin 5 paragrafi 5.2 i kësaj rregullore parashihen në përputhje me afatin e lejes me ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Në dispozitat e nenit 12 të kësaj Rregullore preferohet hyrja në fuqi e Rregullores mbrenda 8 ditësh pas shpalljes publike në tabelën publike të Komunës.

Bazuar në dispozitat e lartëpërmendura,propozoj Kuvendit Komunal KLL-VR.të miratoj Rregullorën ,ashtu sic është e prepozuar në lëndë.

Kryesuësi i Kuvendit Komunal
Kllokot-Vrbovc

/ Zarko Dejanovic /

Datë :31.03.2011